

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“WESTERN BALKANS UNIVERSITY” SHPK**

Sot, më datë 10.11.2020 (dymijë e njëzetë), në praninë personale të Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë:

Z. Klodian ALLAJBEU, i biri i Fadil dhe Myrvete, i datëlindjes 21.04.1978, lindur në Berat, dhe banues në Tiranë, Identifikuar me Letërnjoftimin me nr. H804211641.

Nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë tregtare “Western Balkans University” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

1.1.Emri i shoqërisë do të jetë “Western Balkans University” SHPK.

1.2.Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

NENI 2

Forma e shoqërisë

2.1.Forma e shoqërisë tregtare “Western Balkans University” SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

2.2.Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3

Selia e shoqërisë

3.1.Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njësia Bashkiake nr. 4, Rruga e Dibrës, Nr.363, Hyrja nr. 1, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.

3.2.Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

4.1.Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

- 5.1.1. Të hapë Institucione të Arsimit të Lartë dhe institucione të tjera që janë në shërbim sektorit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
- 5.1.2. Të hapë kurse parauniversitare, kurse gjuhe, shkolla profesionale, institute, laboratore, qendra kerkimore-zhvillimore, poliklinika, qendra dhe parqe shkencore dhe teknologjike.
- 5.1.3. Të hapë dhe administrojë konvikte për studentë, të ofrojë shërbime kancelerie (printim, fotokopjim, skanim, etj) dhe shërbime catering.
- 5.1.4. Të ofrojë edukim në gjuhën angleze, italiane dhe shqipe në nivelet 5 – 8 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (programe profesionale, bachelor, master profesional, master i shkencave, master ekzekutiv, programe te studimeve specializuese afatgjata dhe doktoraturë) si dhe kurse formimi profesional dhe programe trajnimi në kuadër të të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- 5.1.5. Në përputhje me vizionin dhe misionin e tij të kryejë kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar, studime, ekspertize shkencore, projekte për zhvillim dhe veprimtari te tjera krijuese dhe inovative që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimit në vend e me gjerë.
- 5.1.6. Të kryejë publikime (botime librash, revistash, etj.), të organizojë ëorkshope, shkollë verore, konferenca, seminare, simpoziume, leksione të hapura, ekspozita, konkurse, etj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 5.1.7. Të ushtrojë aktivitet me karakter akademik, kërkimor-shkencor, aplikativ dhe inovativ.
- 5.1.8. Të ofrojë shërbim të analizave laboratorike mjekësore për qëllime didaktike, kërkimore por dhe si shërbim ndaj të tretëve.
- 5.1.9. Të ofrojë shërbime konsulence në fushat e ekspertizës.
- 5.1.10. Të krijojë struktura që mbështesin krijimin e bizneseve të reja (start-up-et) në fushën e mjekësisë, teknologjisë, ekonomisë dhe biznesit.
- 5.1.11. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë pavarësisht fushës së veprimtarisë.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

6.1. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) Lekë.

- 6.2.Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 100 (njëqind) Lekë.
- 6.3.Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku i vetëm themelues në total dhe do të shlyhet prej tij.

NENI 7

Organet Drejtuese

- 7.1.Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë:
1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimarrës;
 2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 7.2.Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8

Administrimi

- 8.1.Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2.Administratori i Shoqërisë “Western Balkans University” SHPK është **Znj. Irma GJANA**, shtetase shqiptare, e bija e Kijos dhe Elmës, e datëlindjes 22.09.1980, banuese në adresën: Rrapo Hekali, Nd. 17, Ap. 20, Farkë, Selitë, 1044, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. I05922056I, e cila zgjidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.
- 8.3.Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

- 9.1.Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe parashikimet e Statutit të nënshkruar nga Ortaku Themelues.

NENI 10

Regjistrimi

- 10.1.Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11
Dispozitat përfundimtare

11.1.Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues.

“WESTERN BALKANS UNIVERSITY” SHPK

ORTAK THEMELUES

Z. Klodian ALLAJBEU

